

Letër Pozicionimi për Mbetjet Urbane

Hyrje

Kjo letër pozicionimi i drejtohet vendimmarrësve vendorë: Kryetarëve dhe Këshillave të njësive të qeverisë vendore dhe shpreh mendimin dhe dëshirën e OJF-ve mjedisore për të kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane.

Sektori i OJF-ve mjedisore në Shqipëri identifikon si domosdoshmëri përmirësimin e situatës në lidhje me mbetjet urbane në bashkitë dhe komunat e vendit. Me anë të kësaj letre ky sektor ofron mendim alternativ për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane që gjithësesi janë kompetencë e plotë e pushtetit vendor.

Rekomandimet e ofruara ndihmojnë jo vetëm në përmirësimin e situatës ekzistuese por dhe në zbatimin e detyrimeve ligjore të parashtruara për komunat dhe bashkitë nga kuadri ligjor kombëtar.

Detyrimet ligjore kombëtare janë rrjedhë logjike e angazhimeve që Shqipëria duhet të përmbushë në kuadër të procesit të stabilizimit asocimit në BE. Duke shfrytëzuar edhe ekspertizën e fushës, OJF-të mjedisore ofrojnë jo vetëm alternativë për zgjidhjen e problemit të mbetjeve po shprehin dhe gatishmërinë për të ndihmuar në përmbushjen e standarteve të kërkuara në kuadër të integritetit në BE.

Në takimin e Dhjetorit 2006¹ të OJF-ve mjedisore u identifikua si përparësi e sektorit kërkesa dhe mbështetja ndaj qeverisë vendore në përmbushjen e detyrimeve ligjore përsa i përket menaxhimit të mbetjeve urbane. Në vijim të kësaj nisme, në Takimin Kombëtar të 2008, OJF-të mandatuan një grup pune i cili mban rolin e sekretariatit të OJF-ve mjedisore. Ky sekretariat i përbërë nga specialistë të fushës, me dëshirë për të kontribuar në forcimin e sektorit mjedisor në nivel vendor, arriti te:

- Analizojë gjendjen ekzistuese të mbetjeve urbane;
- Konsultojë kuadrin ligjor të aplikueshëm në menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Analizojë detyrimet që duhen përmbushur në kuadër të procesit të aderimit në BE;

Takimet e sekretariatit janë lehtësuar nga Milieukontakt dhe janë shfrytëzuar informacionet mbi praktikatat më të mira Evropiane marrë me anë të kontakteve me rrjetet përkatëse të OJF-ve.

¹ Takimi i 6të kombëtar i shoqatave

Kjo letër pozicionimi, do të shërbejë si platformë veprimi për hartimin e fushatave për OJF-të mjedisore që synojnë përmirësimin e situatës në lidhje me mbetjet urbane. Fushatat në nivel vendor do të përceptohen në një mënyrë të tillë që të punohet së bashku me organet e qeverisë vendore.²

Situata aktuale dhe analiza e situatës

Vendi është duke u përballur me rritje të prodhimit të mbetjeve dhe në të njëjtën kohë me një keq menaxhim të tyre. Ndërsa mbledhja dhe transporti funksionojnë pjesërisht, elementë të tjera të sistemit të menaxhimit të mbetjeve si riperdorimi, riciklimi, ndarja e klasifikuar, kompostimi, traitimi i vecantë i mbetjeve të rrezikshme dhe atyre të kujdesit shëndetësor dhe trajtimi i sigurt janë të pazhvilluar ose jo ekzistente. Kjo shkakton reziqe serioze si për shëndetin e njerëzve ashtu edhe për degradimin e metejshëm të mjedisit.

Në nivel kombëtar prodhohet rreth 722 000 ton mbetje në vit, me një normë mesatare prodhimi rreth 250 kg për banor në vit në zonat urbane dhe 170 kg në zonat rurale³. Bashkitë dhe komunat kanë përgjegjësinë ligjore, mes detyrimeve të tjera, për mbledhjen, transportin dhe trajtimin e mbetjeve urbane, shërbim publik i cili është tejet i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së jetës dhe ruajtjen e mjedisit.

Ndër problemet më kryesore në drejtim të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane mund të përmendim:

Gjenerimi

Bashkitë dhe komunat nuk janë të pajisura me mjetet e nevojshme dhe mekanizmat e duhura për të karakterizuar dhe monitoruar mbetjet urbane. Gjithashtu mungojnë njohuritë teknike, përbërja merceologjike e mbetjeve, si dhe regjistri kombëtar i mbetjeve dhe monitorimi i saktë i tyre. Kjo e bën të vështirë procesin e hartimit të politikave në drejtim të menaxhimit të mbetjeve urbane apo edhe adoptimin e politikave qendrore dhe përshtatjen e tyre në nivel vendor.

Mbledhja dhe transporti

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit kryhet nëpërmjet: kontraktimit të operatorëve privat ose nëpërmjet ndërmarrjeve vendore. Megjithatë, ky shërbim, në asnjë rast nuk mbulon gjithë sipërfaqen administrative të njërive të qeverisjes vendore, për më tepër në disa zona rurale shërbimi mungon fare.

² Milieucontact International do të mbështesë shoqatat mjedisore shqiptare në hartimin dhe zbatimin e fushatave kombëtare për çështjet e Ujit, Ajrit, Mbetjeve dhe Pjesëmarrjes Publike.

³ Strategjia ndërsektorale e mjedisit 2007

Mungesa e standarteve në ofrimin e shërbimit të mbledhjes, transportit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, ka bërë që ky shërbim, të mos plotësojë kërkesat higjienike e mjedisore. Në të njëjtën kohë duke u zhvendosur nga qendra e një qyteti drejt periferisë apo duke u krahasuar ndërmjet bashkive dhe komunave të ndryshme, vërehet që shërbimi nuk jepet në të njëjtën cilësi.

Monitorimi i këtij shërbimi të ofruar nga kompanitë e kontraktuara lë për të dëshiruar. Po kështu një performancë e tillë vërehet dhe në rastin e ofrimit të këtij shërbimi nga vetë ndërmarrjet bashkiake.

Minimizimi, ripërdorimi dhe riciklimi

Mungojnë politikat mjedisore si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor që nxisin përkrahjen e bizneseve miqësore me mjedisin apo politika që vlerësojnë dhe taksojnë bizneset me përdorim të lartë ambalazhi. Prodhuesit, importuesit, dhe të tjerë në spektrin e prodhuesve nuk mbajnë përgjegjësi për ndikimin në mjedis të produkteve të tyre dhe paketimit.

Megjithëse janë evidentuar disa nisma apo individë që merren me mbledhje apo përpunimin e një fraksioni të caktuar të mbetjeve urbane për vleftësim, mund të themi se këto aktivitete janë kaotike dhe të paorientuara apo të mbeshtetura nga politika të përshtatshme. Po kështu mungojnë politikat nxitëse për ndarjen e mbeturinave që në burim. Ajo që është e nevojshme është një sistem koherent, i ndjeshëm, i mirë-projektuar që stimulon parandalimin, ripërdorimin, riciklimin, kompostimin, dhe format e tjera të vleftësimit.

Në menaxhimin e mbetjeve urbane, evidentohet mjaft qartë edhe sektori informal, ku bëjnë pjesë të gjitha ato shtresa të popullsisë të cilat nxjerrin jetesën e tyre përmes aktivitetit me mbetjet urbane. "Mbledhësit" e fraksioneve të riciklueshme të mbetjeve e ushtrojnë aktivitetin e tyre "eksplorues" si në pikat e grumbullimit të shpërndara nëpër qytet ashtu edhe në fushat ku depozitohen mbetjet pa asnjë kriter. Shpesh herë sidomos në qytet, si pasojë e shpërhapjes së mbetjeve rreth e rrotull pikave të grumbullimit, vihet re një ndikim i madh pamor, mjedisor dhe në shëndetin e njerëzve. Ekziston një nevojë urgjente për të punuar me mbledhësit, për të përmirësuar kushtet e punës, legjitimitetin e tyre si riciklues, dhe aksesit të tyre në kredi dhe informacione teknike, për të përmirësuar performancën mjedisore të mbledhjes, pa i hequr këtyre personave mjetet e tyre tradicionale të jetesës.

Asgjesimi i mbetjeve

Bashkitë dhe komunat janë të detyruara me ligj, për të trajtuar dhe asgjësuar mbetjet urbane, e megjithatë asnjë metode trajtimi, përvec disa rasteve të veçuara të mbetjeve spitalore, nuk aplikohet për asgjësimin final të mbetjeve. Mbetjet thjesht depozitohen në fusha të hapura duke u vetëdjegur dhe shpesh herë duke u bërë burim infeksionesh dhe përhapje sëmundjesh nga më të ndryshmet. Për më tepër shkarkimi i të gjitha llojeve të mbetjeve (përfshirë këtu edhe mbetjet e rezikshme) e rrit edhe më shumë rrezikun.

Ndërgjegjësimi qytetar

Një vëzhgim i shpejtë rreth perceptimit individual mbi shkallën e ndërgjegjësimit mjedisor të qytetarëve, nxjerr në pah menjëherë shkallën e ulët të edukatës mjedisore në përgjithësi dhe sjelljet e lidhura me mbetjet në veçanti. Kjo gjendje jo e favorshme është rrjedhojë e mostrajtitimit të mjedisit, si një komponent i rëndësishëm i funksionimit të pushteteve vendore nga njëra anë dhe e reduktimit të vlerave edukuese të komunitetit dhe shkollës nga ana tjetër.

Qytetarët nuk janë të gatshëm të japin ndihmesë për të zvogëluar e sasinë e mbetjeve të prodhuara dhe aq më tepër të ndërmarrin procesin e ndarjes dhe riciklimit të tyre. Shpesh ndeshemi me fenomenin e hedhjes pa kriter të mbeturinave të gjeneruara duke shkaktuar kështu "ishuj" të mëdhenj e të vegjël me mbeturina në të gjithë territorin e Republikës. Pjesa më e madhe e qytetarëve nuk janë të ndërgjegjshëm për detyrimet e tyre dhe kjo verëhet mjaft qartë në mos pagesën e tarifës së pastrimit nga një pjesë e mirë e tyre. Në një pjesë të mirë të bashkive kjo shoqërohet me përdorimin e mekanizmave jo-ligjorë për vjeljen e këtyre detyrimeve, ndërkohë që në nivel komunash në më të shumtën e rasteve nuk ekziston një tarifë për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve.

Pushteti vendor ka kapacitete njerëzore dhe financiare shumë të kushtëzuara për të adresuar në mënyrë të duhur informimin dhe ndërgjegjësimin qytetar.

Ka një pjesëmarrje të ulët të grupeve të interesit në hartimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve urbane (mungon procesi i hartimit të planeve me pjesëmarrje);

Rekomandime

- Të hartohet **kuadri rregullator** vendor për standartet e ofrimit të shërbimit.
- Të sigurohet forcimi i kapaciteteve për zyrtarët publikë vendorë.
- Të përllogaritet kostoja totale për mirëadministrimin për çdo segment të ciklit të mbetjeve dhe të përdoret kjo kosto si bazë për përcaktimin e tarifës së pastrimit.

- Të përqafohen koncepte të reja për një sistem të diferencuar tarifash për biznese që praktikojnë reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave të prodhuara, duke marrë parasysh parimin "Ndotësi paguan".
- Të zgjerohet shtrirja e bazës së tarif paguesve nga të gjithë konsumatorët që e përfitojnë këtë shërbim më parë se të fillojë një rritje e tarifës
- Cdo rritje e tarifës së shërbimit duhet të shoqërohet detyrimisht me rritje të nivelit të shërbimit të ofruar.
- Të bëhet **transparenca** e shërbimit, kostos dhe subvencionimit të tij;
- Të zhvillohen modele të përshtatshme në nivel lokal, politika dhe plane për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin me përfshirjen e aktorëve kyç.
- Ngritja e një sistemi koherent, të ndjeshëm, të mirë-projektuar që stimulon parandalimin, ripërdorimin, riciklimin, kompostimin, dhe format e tjera të vleftësimit.
- Të lehtësohet pjesëmarrja e ndërmarrjeve ricikluese të mëdha, të mesme, e të vogla dhe informale, në ofrimin e shërbimeve;
- Të bëhet formalizimi i sektorit të mbledhësve për të përmirësuar kushtet e punës, legjitimitetin e tyre si riciklues, dhe aksesin e tyre në kredi e informacione teknike, për të përmirësuar performancën mjedisore të mbledhjes, pa i hequr këtyre personave mjetet e tyre tradicionale të jetesës.
- Gjate hartimit të kontratave, në rastin kur shërbimi kontraktohet nga një subjekt privat, të nxiten skemat e bashkëpunimit win-win ndërmjet paleve. Elemente të rritjes së ndergjegjesimit të publikut duhet gjithashtu të jenë pjesë e kontratave të shërbimit.
- Të plotësohet sistemi i menaxhimit të mbetjeve urbane në të gjitha hallkat duke përfshirë dhe trajtimin e tyre, hallkë kjo që mungon në të gjitha njësitë vendore.
- Mekanizmat joligjore të përdorura për vjeljen e tarifave të lihen mënjanë e të zëvendësohen me mekanizma të tjerë gjithpërfshirës e të qendrueshëm deri në rritjen e vetëdijes së plotë qytetare.
- Të ngrihen partneritete të qendrueshme ndërmjet OJFve dhe pushtetit vendor me qëllim informimin dhe ndergjegjesimin e publikut.
- Të krijohet shëmbujt pozitivë përmes vendosjes së infrastrukturës për grumbullimin dhe ndarjen e mbetjeve në shkolla, nëpërmjet projekteve që nxisin edukimin mjedisor.